

PROCEDURA DHE RREGULLAT PER RREGJISTRIMIN E TE GJITHE STUDENTEVE TE VITEVE

II, III, NE SEZONIN E RIPROVIMEVE (TE MBARTURAVE) 2020-2021

Keto rregulla jane unike per te gjithë studentet e viteve te dyta, te treta, ne te gjitha ciklet e studimit: JP-KP, BA-KP, MP dhe MSC te cilet jane te rregjistruar dhe vazhdojne rregullisht studimet ne vitin akademik 2020-2021.

Per sezonin e te mbarturave 2020-2021 kane te drejte te rregjistrohen vetem studentet e vitit te dyte, te trete, te cilet jane te regjistruar paraprakisht ne vitin akademik 2020-2021 dhe kane provime te mbartura nga vitet akademike te meparshme.

Theksojme se ne kete sezon keta studente mund te japin vetem provime nga lendet te cilat nuk i kane mare gjate viteve akademike te meparshme.

Studentet duhet te rregjistrohen vete ne lendet qe do te japin provim. Me poshte tregohet rregullat dhe procedura e rregjistrimit.

1. Sezoni i te mbarturave per vitin akademik 2020-2021 eshte: 09 prill - 14 prill 2021.
2. Sa data provimesh do te jene ?.....(3) (12 prill, 13 prill dhe 14 prill)
3. Per nje lende te caktuar sa data provimesh do te lihen ?.....(1)
4. Ne sa provime do te futet studenti ne nje dite ?.....(deri ne 3 provime ne orare te ndryshme)
5. Sa provime mund te jape studenti ne sezonin e te mbarturave?.....(deri ne 6)
6. Studenti mund te prenotohet vetem nje here per te njejtin provim.
7. Per sezonin e te mbarturave rregjistrimi i studenteve per provime do te perfshije periudhen 09 prill – 11 prill 2021.

Sekretarite mesimore duhet te pergatitin paraprakisht grafiket e provimeve.

8. Pas kesaj date asnje student nuk mund te kryeje veprime per rregjistrime ne provimet e sezonit te te mbarturave 2020-2021.
9. Ne provimet e sezonit te te mbarturave 2020-2021 nuk do te futen studentet qe s'kane paguar.
10. Kujtojme se per tu rregjistruar ne sezonin e te mbarturave, te gjithë studentet duhet te jene te pasjitur me te dhenat qe ata kane vendosur vete per te hyre ne sistemin e digjital.
11. N.q.s studentet kane problem me keto te dhena atehere te komunikojne sa me shpejt me sekretarite mesimore te fakultetit perkates per tu njohur me to.
12. Menyra e rregjistrimit ne provimet e sezonit te te mbarturave 2020-2021 eshte njesoj sikurse dhe ajo e sezonit te vjeshtes 2019-2020 (online).
13. Ne sezonin e te mbarturave pedagogu qe merr studentet ne provim, eshte ai qe eshte percaktuar ne kurrikulen e studimeve te atij viti akademik (2020-2021) dhe jo pedagogu i vitit te kaluar.
14. Per te gjithë studentet te cilet duan te japin ne sezonin e te mbarturave 2020-2021 lende te cilat i kane patur te pafrekuentura gjate viteve akademike te meparshme por i kane frekuentuar gjate sem I, te vitit akademik 2020-2021 duhet :
 - a. Te verifikojne ne librezin e tyre online para sezonit, vendosjen e frekuentimit te lendes ne sistemin dixhital te vleresimit. Ne te kundert studenti nuk do te mund te prenotohet nga websiti i tij ne provimin e kesaj lende per kete sezon.
 - b. Studenti shkon ne websitin e tij dhe rregjistrohet sipas procedurave te percaktuara ne linkun ' **Sherbime online-ESSE3** ' ne websitin e universitetit : <http://www.unkorce.edu.al>

Kujdes**. Pas dates se provimit studentet nuk mund te rregjistrohen per provim ne kete sezon.**